



Data: 12.04.2019

Ref.: 591/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 66-të, të mbajtur më 27 mars 2019, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet ankesa Nr.434/19H, datë 15.03.2019 e Kolegjit AAB, si e bazuar.
2. Ndryshohet pika I (një) e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.309/19D, datë 25.02.2019.
3. Aprovohet aplikacioni i Kolegjit AAB, për akreditim të programeve të studimit:
 - 3.1 Menaxhment Shëndetësor, MSc, 120 ECTS, dhe
 - 3.2 Siguri Kibernetike dhe Sistemet e Informacionit, Bachelor Profesional, 180 ECTS.
4. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.309/19D, datë 25.02.2019 mbetet e pa ndryshuar.
5. Autorizohet Drejtori i AKA-së për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme, konform dispozitave ligjore ne fuqi.

Arsyetimi

KSHC me vendim Nr.309/19D, datë 25.02.2019 ka refuzuar aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, Siguri Kibernetike dhe Sistemet e Informacionit, Bachelor Profesional, 180 ECTS; Menaxhment Shëndetësor, MSc, 120 ECTS; Infermieri, MSc, 120 ECTS, dhe Psikologji Klinike, MA, 120 ECTS.

Kolegji AAB, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.309/19D, datë 25.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 15.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).


Përmes kësaj ankesa, Kolegji AAB ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programet e studimit, Siguri Kibernetike dhe Sistemet e Informacionit, Bachelor Profesional, 180 ECTS, dhe Menaxhment Shëndetësor, MSc, 120 ECTS, të cilat kanë qenë objekt i trajtimit me vendimin e KShC-së Nr.309/19D, datë 11.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 66-të të KShC-së, të mbajtur me 27 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programet e studimit, Siguri Kibernetike dhe Sistemet e Informacionit, Bachelor Profesional, 180 ECTS, dhe Menaxhment Shëndetësor, MSc, 120 ECTS, i plotësojnë kushtet për të qenë bartës të programeve të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kolegji AAB;
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

